



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA "YMER LALA" SURREL

Nr: 201 Prot

Tiranë, më 21.04.2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Shkolla "YMER LALA", Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vende të lira të punës në pozicionet:

- 1. Mësues i gjuhës frënge**
- 2. Mësues i gjuhës angleze**
- 3. Mësues i edukimit fizik**

Të gjithë mësuesit e këtyre profileve, të interesuar për këto pozicione pune, duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës "YMER LALA", Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
- CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- Raportin mjeko - ligjor.
- Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
- Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës "YMER LALA", Tiranë, me adresë Surrel komuna Dajt Tiranë, cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00, me procesverbal dorëzimi. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të jetë data 30.04.2015 ora 14.00.

DREJTOR

Angjeli THANASI

